



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 42.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe Vendimit të dt.21.12.2022, të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: : **632-21-6570-5-2-1 dhe nr.të brendshëm 632-21-121-521**, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-31803, për shkak të pamundësisë- mos lejimit e ndërtimit të pendës në lumin Drin nga MMPHI-ja, për arsye se lumenjtë janë nën Administrimin e Ministrisë përkatëse. në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 01.09.2023, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

Neni 42, paragrafi 42.1 i KPK përcakton se “Palët do t’i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën”

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 20.10.2021, me numër të prokurimit: : **632-21-6570-5-2-1 dhe nr.të brendshëm 632-21-121-521**, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-31803, me titull “**Ndërtimi i pendës te ura e Fshejtë në lumin Drin-Kontratë dy vjeçare**”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve **Lulzim Beqiraj B.I.; FIDANI-BETON SH.P.K., me seli Rr. Arben Qerimaj , Nr 180, Deçan**, do të ndërpritet me marrëveshje mes dy palëve me date 04.09.2023.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne Vendimin e dt.21.12.2022, të Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në nenin 42, paragrafi 42.1, te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Për shkak të pamundësisë- mos lejimit të ndërtimit të pendës në lumin Drin nga MMPHI-ja, për arsye se lumenjtë janë nën Administrimin e Ministrisë perkatëse , palët kontraktuese kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

Shkresës i bashkëngjiten kërkesa e Operatorit ekonomik dhe rekomandimi i Menaxherit të kontratës për shkëputje të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	16.08.2023
REFERENC-Ë:	06/Zyrtarisht
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj DHE - z. Ferdinand Kolaj
CC:	z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës, Gjakovë
NGA/OD/FROM	Avdyl Nuraj – Projekt Menaxher i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim për ndërprerje të kontratës me titull: "NDERTIMI I PENDES TE URA E FSHEJTE NE LUMIN DRIN "

Të nderuar

Lidhur me kontratën me titull " NDERTIMI I PENDES TE URA E FSHEJTE NE LUMIN DRIN-KONTRATË DY VJEQARE Nr. Iden. 632-21-6570-5-2-1 e lidhur ne mes te Komunës se Gjakovës dhe grupit të OE " FIDANI L SH.P.K. ; FIDANI -BETON SH.P.K " ju njoftojmë se: Punimet kanë filluar sipas urdhërësës të lëshuar nga Projekt Menaxheri . Pas kryerjes se te gjitha punimeve në " Hapesirat Rekreative ", bazuar në raportet e organit Mbikëqyrës dhe vizitës në terren, të Situacionit dhe raporteve të Organit Mbikëqyrës:

Situacioni i Parë: Vlerë: 149'980.84 Euro - Me datë- 16.12.2021

Situacioni i Dytë: Vlerë: 69'648.26 Euro - Me datë- 18.05.2022

Situacioni i Tretë: Vlerë: 74'770.90 Euro - Me datë- 27.10.2022

Situacioni i Katërt: Vlerë: 13'444.98 Euro - Me datë- 30.06.2023

Vlera totale e Situacioneve: 307'844.98 Euro

Ndërtimi i pendës me Vlerë: 89'344.37 Euro,

Vlera totale e kontratës : 397'189.35 Euro

Nga fillimi i kontratës është bërë kërkesa nga Autoriteti Kontraktues- Komuna e Gjakovës drejtuar Ministrisë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për lejin e ndërtimit të pendës në lumin Drin, për arsye se lumenjtë janë nën Administrimin e Ministrisë përkatëse.


Përgjegjja e Ministrisë ishte negative ku nuk e lejuan ndërtimin e pendës në lumin Drin.

Duke u bazuar në nenin 42 të kontratës në K. Gjakovës me OE, rekomandoj ndërprerje të kontratës me marrëveshje në mënyrë paqësore.

Kërkojmë nga Kryetari komun137s Zt.A.Gjini dhe Zyra e Prokurimit që të ndërpritet kjo kontratë me punë kryesin dhe të bëhet prerja e punimeve sepse nuk ka mundësi të ekzekutohet.

Projekt Menaxheri :

Avdyl Nuraj



Venera Shtaloja

From: Avdyl Nuraj
Sent: Thursday, August 24, 2023 1:40 PM
To: Ferdinand Kolaj
Cc: Ardian Gjini; Faton Gutaj; Venera Shtaloja
Subject: Rekomandim per shkeputje te kontrates
Attachments: arpl perfundim i procedures kk gjakov 4045 22.pdf; Ura e fshajt.docx

Të nderuar!

Luteni të vazhdoni me procedurat tjera për shkeputje të kontratës me marrëveshje me OE "Fidani L" për projektin "Ndërtimi i Pendës të Ura e Fshajt", situacionet tjera janë krye të gjitha, ka mbete vetëm ndërtimi i Pendës në lumin Drin, e cila nuk mund të realizohet për momentin, bashkangjitur gjeni rekomandimin dhe përgjigjen nga ARPL-ja në lidhje me kete projekt.

Me respect;
Avdyl Nuraj
Menaxher i projektit



KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Projekti Objekti Nr. Dokument Drejtoria	AAPL - 03 -
Nr. Dokument Drejtoria	4045-2/22 30.12.22
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	21.12.2022
REFERENC-Ë:	4045/22 - ZSP - 2022
PËR/ZA/TO:	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, K. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Servet SPAHIU , Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL-së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përfundim i procedurës administrative

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas kërkesës, me Nr.4045/22, për pëlqim ujqor, ARPL-ja përfundon procedurën administrative për Projektin e rikonstruimit të pendës te Ura e Shejt, të bashkangjitur si në shkresën përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Datë: 21.12.2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 dhe 97 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 27 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Përfundohet procedura administrative, me Nr. Protokol 1045/22, parashituar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, për Projektin e Rikonstruimit të Pendës të Ura e Shenjtë

Arsyetim

Zyrtari përgjegjës, duke u bazuar në atë se pala e cila ka aplikua për pëlqim ujqor lidhur me projektin per rikonstruim të Pendës të Ura e Shenjtë, ka bërë shikimin në vend.

Gjatë vizitës në terren, përfaqësuesi i Komunes Z. Lon IBISHI, Zyrtarë për Zhvillim Ekonomik, është deklaruar se Komuna e Gjakovës në pamundësi të arritjes së marrëveshjes me K. e Rahovecit , është vendosur nga K. Gjakovë ta tërheqë kërkesën nga MMPHI-ja, deri në hartimin e një projekti të përbashkët dhe arritjes së

marrëveshjes me K. e Rahovecit, pasi që Penda egzistuese i përket të dy Komunave, atë të Gjakovës dhe Rahovecit.

Andaj bazuar në këtë, palës i ndërpritet procedura administrative.

Ndërprerja e procedurës administrative, nuk e sanksionon palën nga riaplikimi.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 4045/22 - ZSP- 2022, datë: 21.12.2022

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Gjakovë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zavendësues Sekretar Përgjithshëm i MMPHI-së

